



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 14363 prot.

Shkodër, më 01.07. 2026

**VENDIM
Nr. 48, datë 30.06.2026**

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR DHE
DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E GJOVALIN LUCËS, BANESA E SË CILËS ËSHTË
DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2026, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Ligjin nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë së Shkodrës”, i ndryshuar; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 40, datë 30.04.2026 “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër’”, i ndryshuar, si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare për familjen e Gjovalin Lucës, e përbërë nga 5 anëtarë, në vlerën 100 000 lekë, sipas certifikatës familjare të paraqitur, për dëmtimin e banesës së tyre nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor të hartuar nga Bashkia Shkodër për familjen e Gjovalin Lucës, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, konkretisht: dëme ndërtimore në vlerën 242 854 lekë (*dyqind e dyzet e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e katër lekë*); dëme në orendi dhe pajisje në vlerën 130 580 lekë (*njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë lekë*).

3. Burimi i financimit për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare, në vlerën 100 000 lekë (*njëqind mijë lekë*), do të jetë fondi i emergjencave civile, i parashikuar në programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile”, në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2026, të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë së Shkodrës”, në zërin Q2 O1 A5 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”. Për likuidimin e ndihmës së menjëhershme financiare ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër.
4. Kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore, si dhe i dëmeve në orendi dhe pajisje për familjen e Gjovalin Lucës, do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit të hartuara nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 41; VKM-së nr. 329, datë 16.05.2012, pika 3; VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, pika 3.1/a “Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”; si dhe VKB-së nr. 40, datë 30.04.2026 “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2026 të miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028 të Bashkisë Shkodër’”, i ndryshuar. Sipas relacionit bashkëlidhur këtij vendimi, kompensimi miratohet si më poshtë: në masën 50% të vlerës së dëmeve ndërtimore, në shumën 121 427 lekë (*njëqind e njëzet e një mijë e katërqind e njëzet e shtatë lekë*); në masën 50% të vlerës së dëmeve në orendi dhe pajisje, në shumën 65 290 lekë (*gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nëntëdhjetë lekë*).
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 39 vota

Vota Pro	39
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	01.07.2026

SEKRETARE

Sabina Danaj

